



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.277/350-24366 datë 17.06.2022
REFERENC-Ë:	07Nr.350-24366 datë 22.04.2022
PËR/TO:	“Logi Grôp” SH.P.K me përfaqësues Hajrush Kukaj Lubizhdë-Prizren dhe N.N.T. “ETNIKU” me përfaqësues Tahir Bugari Samadrexhë-Suharekë
KOPJE/COPY:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë Arkivit të Komunës
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	Drejtor i drejtorisë: Visar KUÇI Zyrtare e lartë për ndërtimtari: Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-24366 datë 22.04.2022 nga **“Logi Group” SH.P.K me përfaqësues Hajrush Kukaj Lubizhdë-Prizren dhe N.N.T. “ETNIKU” me përfaqësues Tahir Bugari Samadrexhë-Suharekë**, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim Depo ushqimore me etazhitet adminstrata P+1 dhe depoja PL, në parcelën kadastrale 02785-12, Parcela ndërtimore P-071, me numër referues të çertifikatës Nr.11-463-1302/2022 datë 07.04.2022, Pasuri Shoqërore Shfrytëzues i Përhershëm Kuvendi Komunal Suharekë, Zona Kadastrale Suharekë dhe Kontratës për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Suharekës me numër 01Nr.016-11495 datë 16.02.2021, në emër të **“Logi Group” SH.P.K me përfaqësues Hajrush Kukaj dhe N.N.T “Etniki” me përfaqësues Tahir Bugari**, andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

- AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 17.06.2022

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.277/350-24366

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, duke u mbështetur në Planin Rregullues Urban "Zona Industriale" 01Nr.10074 datë 21.04.2009 kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga "Logi Group" SH.P.K me përfaqësues Hajrush Kukaj Lubizhdë-Prizren dhe N.N.T. "ETNIKU" me përfaqësues Tahir Bugari Samadrexhë-Suharekë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	"Logi Group" SH.P.K-Hajrush Kukaj dhe N.N.T. "Etniku"- Tahir Bugari	Nr. Personal	
Adresa:	Lubizhdë-Prizren Samadrexhë-Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350-24366 dt. 22.04.2022

Emri I Projektit:	Depo ushqimore		
Emri I Projektuesit:	"LK Invest" sh.p.k. Prishtinë		
Adresa:	Rruga "Rifat Burdeviç" Nr.1 Prishtinë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI			
Adresa: Rr "Ukë Bytyqi", Shirokë			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës:	GPS Koordinatat e objektit:	
Sipas certifikatës me Nr.11-463-1302/2022 datë 07.04.2022 Zona Kadastrale Suharekë	02785-12	Y=7484392.717 Y=7484372.784 Y=7484394.308 Y=7484371.366	X=4689991.236 X=4689987.666 X=4689999.515 X=4689995.999

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Depo ushqimore			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Gabariti	(20.6 x 72.45) m' (44.4 x 20.0)m'	Katshmëria:	Administrata (P+1) dhe Depo PL me sipërfaqe Bruto 2531.04m ²
Vija rregullative	Nga mesi i rrugës B-B 8.0m'	Vija ndërtimore	15m' nga vija rregullative, ndërsa ka parcelat fqinje min 5m'

Përshkrimi
Me këtë vendim, poseduesit të lejës ndërtimore “Logi Group” SH.P.K me përfaqësues Hajrush Kukaj Lubizhdë-Prizren dhe N.N.T. “ETNIKU” me përfaqësues Tahir Bugari Samadrexhë-Suharekë, i lejohe ndërtimi i objektit me destinim Depo ushqimore me etazhitet adminstrata P+1 dhe depoja PL. Lokacioni i objektit është në kuadër të Planin Rregullues Urban "Zona Industriale" 01Nr.10074 datë 21.04.2009, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelën kadastrale 02785-12, është me destinim Depo të ndryshme ushqimore. Objekti ka karakter të përhershëm. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.498/350-39330 datë 30.08.2021. Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: - Informata mbi Lejën Ndërtimore; - Informata mbi Projektuesin; - Informata mbi Kontraktuesin; - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore; - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit; - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent; - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit; - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit; - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të

- problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit në shtetë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
 - Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
 - Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
 - Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **“Logi Group” SH.P.K me përfaqësues Hajrush Kukaj Lubizhdë-Prizren dhe N.N.T. “ETNIKU” me përfaqësues Tahir Bugari Samadrexhë-Suharekë**, përmes kërkesës 07Nr.350-24366 datë 22.04.2022 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit depo ushqimore, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim rreth Kushteve Ndërtimore 07Nr.498/350-39330 datë 30.08.2021 (kopje)
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.199/350-24366, datë:19.05.2022, në shumë prej 7086.87€, e paguar në Pro Credit Bank në Prishtinë, sipas faturës komunale nr.000851 datë 14.06.22.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.2608 datë:11.10.2021.
- Pëlqim sanitar – nga Inspektori i Sanitar 09Nr.2606 datë:11.10.2021.
- Pëlqim për menagjimin e mbeturinave me Nr.prot.122/21 datë:08.09.2021, lëshuar nga NPRM "Eko-Regjioni" Prizren Njësia Operative Therandë.
- Pëlqimin nga Hidroregjioni Jugor Prizren për Ujësjellës dhe Kanalizim me Nr.212 datë: 13.10.2021
- Informatë nga KEDS-SH.A, Nr.1037 datë: 15.OCT.2021.
- Pëlqimin për rmbrojtjen nga zjarri-nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë

Faqe4nga5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë – Kosovë

Telefon: 029 271 318

www.komuna-suhareke.org, E-mail: urbanizmisuhareke@rks-gov.net

Nr.03/03-99 datë 05.10.2021.

- Lejen Mjedisore Komunale-nga Drejtoria për Shërbime Publike Mjedis dhe Emergjencë 03Nr.125/113-74590 datë 20.04.2022.
- Kordinatat e vendosjes se objektit të planifikuar sipas kushteve ndërtimore nga “Geo-Group” SH.P.K , Prishtinë.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Kopje e dokumentit identifikues

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform Planin Rregullues Urban "Zona Industriale" 01Nr.10074 datë 21.04.2009, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MMPHI në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.277/350-24366 datë 17.06.2022

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së

